# VENDIM
## Nr. 397, datë 13.5.2020
## PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI "NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR UNAZA LOTI 3", TIRANË

*(ndryshuar me VKM nr. 939, datë 27.11.2020; nr. 243, datë 21.4.2021, nr. 487, datë 30.7.2021)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtimi i segmentit rrugor Unaza Lindore Loti 3", Tiranë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë "arë", tokë "truall" dhe "ndërtesë" me vlerë të përgjithshme *1 231 857 207.57 (një miliard e dyqind e tridhjetë e një milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatë pikë pesëdhjetë e shtatë).*

*3/1. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit "truall", me sipërfaqe 1909 (një mijë e nëntëqind e nëntë) $m^2$, me vlerë 62 764 102 (gjashtëdhjetë e dy milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e dy) lekë.*

*4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 231 857 207.57 (një miliard e dyqind e tridhjetë e një milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatë pikë pesëdhjetë e shtatë) lekësh të përballohet:*

*- 959 423 147.57 (nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë milionë e katërqind e njëzet e tre mijë e njëqind e dyzet e shtatë pikë pesëdhjetë e shtatë) lekë, nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vitet 2020–2021;*

*- 111 393 560 (njëqind e njëmbëdhjetë milionë e treqind e nëntëdhjetë e tre mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë, nga buxheti i miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.*

*- 161 040 500 (njëqind e gjashtëdhjetë e një milionë e dyzet mijë e pesëqind) lekë, nga buxheti i miratuar në programin e "Transportit rrugor" në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vitin buxhetor 2021.*

*4/1. Vlera shtesë prej 62 764 102 (gjashtëdhjetë e dy milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e dy) lekësh të përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.*

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën *150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë)* lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

*5/1. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.*

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit, në Autoritetin Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së

projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë në favor të shtetit.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit.

*12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1 dhe Tirana Jug, si dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## Lista e pronarëve që shpronësohen për pasuritë pronë private që preken nga projekti "Ndërtimi i segmentit rrugor Unaza Lindore Loti 3", Tiranë

| Nr. | Emri | Atesia | Mbiemri | Zona Kadast | Numri Pasurise | Lloji i pasurise | Sip. Tot.( m2) | ARE Sip. m2 | ARE Çmimi l/m2 | ARE Vlera leke | TRUALL Sip. m2 | TRUALL Çmimi l/m2 | TRUALL VLERA leke | BANESE SIP m2 | BANESE Çmimi l/m2 | BANESE Vlera leke | NDERTESE Sip. m2 | NDERTESE Çmimi | NDERTESE Vlera (sipas preventivit) | Vlera totale leke |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | HAMDI | MUHAREM | ELEZI | 8180 | 3/269 | TRUALL | 460 | | | - | 7.10 | 31270 | 222,017.00 | | | - | | | | 222,017.00 |
| 2 | P.B MEMA,BARDHI | | | 3976 | 213/30-ND4 | BANESE | 174.2 | | | - | | | - | 174.2 | 66500 | 11,584,300.00 | | | | 11,584,300.00 |
| 3 | OSMAN | MEHMET | HYSA | 8180 | 7.576/ND | BANESE | 100 | | | - | | | - | 100 | 96200 | 9,620,000.00 | | | | 9,620,000.00 |
| 4 | PERPARIM | IRFAN | ÇELA | 8170 | 7/689 | TRUALL | 319 | | | - | 111.88 | 32878 | 3,678,390.64 | | | - | | | | 3,678,390.64 |
| 5 | B.P SULTAFA | | | 8170 | 8.701 | TRUALL+ BANESE | 300 | | | - | 204.30 | 32878 | 6,716,975.40 | 119 | 86400 | 10,281,600.00 | | | | 16,998,575.40 |
| 6 | B.P SULTAFA,SHAPTORE | | | 8170 | 8/740 | TRUALL | 200 | | | - | 200.00 | 32878 | 6,575,600.00 | | | - | | | | 6,575,600.00 |
| 7 | PETRIT | QERIM | MEMA | 8170 | 9.617/ND | BANESE | 70 | | | - | | | - | 70 | 86400 | 6,048,000.00 | | | | 6,048,000.00 |
| 8 | B.P TARE,HAJDINI | | | 8170 | 9/632/ND | BANESE | 110 | | | - | | | - | 110 | 86400 | 9,504,000.00 | | | | 9,504,000.00 |
| 9 | BP.TROKSI,HASANAJ,SHERA,BALLA | | | 8170 | 9/612/ND | BANESE | 375 | | | - | | | - | 375 | 86400 | 32,400,000.00 | | | | 32,400,000.00 |
| 10 | ARBEN | LUAN | LEVENDI | 8180 | 6/614 | TRUALL | 279.2 | | | - | 72.30 | 31270 | 2,260,821.00 | | | - | | | | 2,260,821.00 |
| 11 | QEMAL | RAMAZAN | DISHA | 8180 | 6/681 | TRUALL+NDERTESE | 300 | | | - | 241.00 | 31270 | 7,536,070.00 | | | - | 56 | | 1,550,146.10 | 9,086,216.10 |
| 12 | SELAMI | HAXHI | DERVISHI | 8180 | 6/73+1-2 | APARTAMENT | 57.3 | | | - | | | - | 57.3 | 96200 | 5,512,260.00 | | | | 5,512,260.00 |
| 13 | HALIT | | KAMBERI | 8180 | 7/577/ND | BANESE | 220 | | | - | | | - | 220 | 96200 | 21,164,000.00 | | | | 21,164,000.00 |
| 14 | HAJRI | FERIT | HASKA | 8180 | 7.593 | TRUALL+BANESE | 403 | | | - | 282.00 | 31270 | 8,818,140.00 | 272.3 | 96200 | 26,195,260.00 | | | | 35,013,400.00 |
| 15 | JONUZ | | MUCA | 8180 | 7/596 | TRUALL + BANESE | 330 | | | - | 129.95 | 31270 | 4,063,536.50 | 80 | 96200 | 7,696,000.00 | | | | 11,759,536.50 |
| 16 | DALIP | ABAZ | SHEHU | 8180 | 7/635/ND | BANESE | 122 | | | - | | | - | 122 | 96200 | 11,736,400.00 | | | | 11,736,400.00 |
| 17 | MYQEREM | SHEFIT | SINA | 8180 | 7.648/ND | NDERTESE | 534.4 | | | - | | | - | | | - | 533.7 | | 16,517,886.04 | 16,517,886.04 |
| 18 | AZBI BALLA,MIMOZA SALA | | | 8180 | 7/650/ND | BANESE | 70 | | | - | | | - | 70 | 96200 | 6,734,000.00 | | | | 6,734,000.00 |
| 19 | B.P SHIRA,SHEHAJ,DEDA,QORDJA | | | 8180 | 3/653 | TRUALL | 980 | | | - | 147.49 | 31270 | 4,612,012.30 | | | - | | | | 4,612,012.30 |
| 20 | NIKOLIN FRROK JAKA, SHOQERIA "VIBTIS" SH.P.K | | | 8180 | 6.295 | TRUALL+NDERTESE | 6092 T+2090 nd | | | - | | | - | | | - | 586.6 | | 4,670,327.0 | 4,670,327.00 |
| 21 | MUHARREM | | BATHORJA | 8170 | 7/704 | TRUALL | 498.3 | | | - | 19.70 | 32878 | 647,696.60 | | | - | | | | 647,696.60 |
| 22 | B.P MANCAKU,KURTI | | | 8170 | 7/697 | TRUALL | 400 | | | - | 34.00 | 32878 | 1,117,852.00 | | | - | | | | 1,117,852.00 |
| 23 | MAJLINDA ÇELIKU,ANISA ÇELIKU | | | 8170 | 7/699 | TRUALL | 600 | | | - | 355.00 | 32878 | 11,671,690.00 | | | - | | | | 11,671,690.00 |
| 24 | B.P TABAKU | | | 8170 | 7/740 | TRUALL | 200.97 | | | - | 91.90 | 32878 | 3,021,488.20 | | | - | | | | 3,021,488.20 |
| 25 | HAXHI | MUHARREM | SAUKU | 8170 | 9/558 | TRUALL | 499.8 | | | - | 256.50 | 32878 | 8,433,207.00 | | | - | | | | 8,433,207.00 |
| 26 | QIMULI | KLEANTH | DUVLI | 8180 | 6/8 | TRUALL | 160 | | | - | 6.00 | 31270 | 187,620.00 | | | - | | | | 187,620.00 |
| 27 | B.P DERHEMI,BODINAKU,LIÇI, ETJ | | | 8180 | 6/283 | TRUALL | 150 | | | - | 12.00 | 31270 | 375,240.00 | | | - | | | | 375,240.00 |
| 28 | KRYEGJYSHATA BOTERORE E BEKTASHIANE | | | 8180 | 6/254 | TRUALL | 360 | | | - | 28.00 | 31270 | 875,560.00 | | | - | | | | 875,560.00 |
| 29 | KIMON | ISLAM | KOKOSHI | 3976 | 191/ND/1 | BANESE | 103.5 | | | - | | | - | 103.5 | 66500 | 6,882,750.00 | | | | 6,882,750.00 |
| 30 | BUJAR | XHEMAL | AGA | 3976 | 213/30-ND7 | BANESE | 105 | | | - | | | - | 105 | 66500 | 6,982,500.00 | | | | 6,982,500.00 |
| 31 | PELLUMB | RIZA | DUKA | 3976 | 213/30-ND8 | BANESE | 198 | | | - | | | - | 198 | 66500 | 13,167,000.00 | | | | 13,167,000.00 |
| 32 | SELIME | FAIK | BARAMAJ | 8170 | 9/615-ND | BANESE | 81.89 | | | - | | | - | 81.89 | 86400 | 7,075,296.00 | | | | 7,075,296.00 |
| 33 | XHEMAL | HAJDAR | AGA | 3976 | 213/30-ND5 | BANESE | 210 | | | - | | | - | 210 | 66500 | 13,965,000.00 | | | | 13,965,000.00 |
| 34 | B.P . DUKA,HIDRI | | | 8170 | 9/621/ND | BANESE | 103 | | | - | | | - | 103 | 86400 | 8,899,200.00 | | | | 8,899,200.00 |
| 35 | SEMBIJE | NESHAT | GJINOLLARI | 8170 | 7/741 | TRUALL | 400 | | | - | 117.00 | 32878 | 3,846,726.00 | | | - | | | | 3,846,726.00 |
| 36 | VEHBI | HYSEN | SULA | 3976 | 213/30-ND10 | BANESE | 219.2 | | | - | | | - | 109.6 | 66500 | 7,288,400.00 | | | | 7,288,400.00 |
| 37 | B.P TROKSI | | | 8170 | 9/618/ND | BANESE | 100 | | | - | | | - | 100 | 86400 | 8,640,000.00 | | | | 8,640,000.00 |
| 38 | XHELAL | HYSNI | GURI | 8170 | 7/744 | TRUALL | 400 | | | - | 141.40 | 32878 | 4,648,949.20 | | | - | | | | 4,648,949.20 |

**TABELA QË I SHTOHET TABELËS BASHKËLIDHUR VENDIMIT NR. 397, DATË 13.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI: 'NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR UNAZA LINDORE , LOTI 3', TIRANË"**

| Nr. | Emër, Atësia, Mbiemër | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sip. totale ($m^2$) | Sipërfaqe shpronësimi | | Vlera totale (lekë) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Banesë ($m^2$) | Çmimi banesës/$m^2$ | |
| 1 | Dervish Selim Ahmeti | 3976 | 213/30-ND6 | banesë | 198 | 198 | 66500 | 13,167,000.00 |
| 2 | Kreshnik Selim Ahmeti | 3976 | 213/30/ND-15 | banesë | 358.8 | 358.8 | 66500 | 23,860,200.00 |
| 3 | Shefqet Reshit Balla | 3976 | 190/ND/4 | banesë | 240 | 240 | 66500 | 15,960,000.00 |
| 4 | Shaban Sinani | 3976 | 233/19-ND | banesë | 115 | 115 | 66500 | 7,647,500.00 |
| 5 | Qerime Tosun Serani, Gentian Landi Stenaj | 8180 | 6/702/ND | banesë | 27.4 | 27.4 | 96200 | 2,635,880.00 |
| 6 | Dushan Velo Plaushku | 8180 | 6/31/ND | banesë | 62.2 | 62.2 | 96200 | 5,983,640.00 |
| 7 | Budin Petrush Budini | 8180 | 6/180/ND | banesë | 55.2 | 55.2 | 96200 | 5,310,240.00 |
| 8 | Donika Zoi Drushku | 8180 | 6/770-ND | banesë | 80.5 | 80.5 | 96200 | 7,744,100.00 |
| 9 | Lumturie Nezir Balla, Aida Kujtim Balla, Anxhela Kujtim Balla, Sadete Kujtim Tresa, Vladimir kujtim Balla, Blerina Kujtim Balla, Vera Kujtim Balla | 3976 | 190/ND3 | banesë | 210 | 210 | 66500 | 13,965,000.00 |
| 10 | Xhevahir Memet Filja, Sheqere Jusuf Murati | 8170 | 9/692/ND | banesë | 175 | 175 | 86400 | 15,120,000.00 |
| **VLERA TOTALE** | | | | | | | | **111,393,560.00** |

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 397, DATË 13.5.2020, "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI "NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR UNAZA LINDORE LOTI 3, TIRANË", TË NDRYSHUAR

*(shtuar me VKM nr. 243, datë 21.4.2021)*

| Nr. | Emër Atësi Mbiemër | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sip. totale ($m^2$) | Sipërfaqe shpronësimi | | Vlera totale (lek) | SHËNIM |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Truall ($m^2$) | Çmimi truallit/$m^2$ | | |
| 1 | Genti Haxhi Sauku, Artan Haxhi Sauku, Merita Haxhi Bruci (Sauku) Hana Haxhi Sauku | 8180 | 7/647 | Truall | 8,993.1 | 5150 | 31,270.0 | 161,040,500.0 | **Seksioni D:** Mbi këtë truall pozicionohen ndërtesat me nr. 7/671-nd., 7/664-nd., 7/650/nd., 7/649nd., 7/648/nd. dhe nr. 7/641 nd. **Seksioni E:** Vendoset sekuestro konservative nga shoqëria "Besa" sh.p.k., në favor të *Banka Credins* dhe masa sekuestro konservative. |
| **VLERA TOTALE** | | | | | | | | **161,040,500.0** | |

LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE PËR PASURINË E PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 397, DATË 13.5.2020, "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT 'NDËRTIMI I OBJEKTIT UNAZA LINDORE TIRANË, LOTI 3'"

*(shtuar me VKM nr. 487, datë 30.7.2021)*

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | ZK | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sip. tot. ($m^2$) | ARË | | | TRUALL | | | BANESË | | | NDËRTESË | | | Vlera totale, lek | SHËNIME |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Sip. $m^2$ | Çmimi l/$m^2$ | Vlera, lek | Sip. $m^2$ | Çmimi l/$m^2$ | Vlera, lek | Sip. $m^2$ | Çmimi l/$m^2$ | Vlera lek | Sip. $m^2$ | Çmimi | Vlera (sipas preventivit) | | |
| 1 | REZART | RAMAZAN | KUPTHI | 8170 | 9/705 | TRUALL | **1909** | | | | 1909 | 32878 | 62,764,102.00 | | | | | | | **62,764,102.00** | **Seksioni D:** Mbi këtë truall pozicionohen ndërtesat me nr. 9/612/nd., vol 24, f. 41, hip 1266/93 ksh, mbi këtë truall ka ndërtime pa leje. |
| Mbyllet me nr. rendor 1 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | **TOTALI** | **62,764,102.00** | |